VENDIM
Nr. 881, datë 20.12.2006

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

(Ndryshuar me VKM nr. 446, datë 13.7.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar dhe të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, që gëzojnë të drejtën e gradës, të paguhen në bazë të gradës diplomatike/konsullore, e cila përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si rregull, emërohen:

a) "Përgjegjës sektori", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Sekretar i dytë" apo të barazvlefshme me të;

b) "Drejtor drejtorie", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Sekretar i parë" apo të barazvlefshme me të;

c) "Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Këshilltar" apo të barazvlefshme me të.

3. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike:

a) "Sekretar i dytë", në rastin kur emërohet "Përgjegjës sektori" të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) "Sekretar i parë", në rastin kur emërohet "Drejtor drejtorie" të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) "Këshilltar", në rastin kur emërohet "Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme" të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në rastet kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm, me gradë më të lartë se minimumi i përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të paguhen sipas gradës diplomatike/konsullore, që kanë.

5. Nëpunësit e tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që nuk gëzojnë të drejtën e gradës diplomatike/konsullore, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi, konkretisht, të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet përkatëse", të ndryshuar, si dhe vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i

vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

7. Vendimi nr.324, datë 21.5.2004 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(Ndryshuar me VKM nr. 446, datë 13.7.2007)

Lidhja nr. 1

		PAGA MUJORE			
POZICIONI DREJTUES	**GRADA DIPLOMATIKE**	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA PER GRADE
	1	*2*	*3*	*4*	*5*
		Paga e grupit (PG) leke	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Sekretar i Pergjithshem	Ambasador	10.050	2%	0	110.900
Drejtor i Përgjithshem	Minister Fuqiplote. Minister Keshilltar. Konsull i Pergjithshem.	10.050	2%	0	100.500
Drejtor	Keshilltar.	10.050	2%	0	84.000
Pergjegjes Sektori	Sekretar i Pare. Konsull.	10.050	2%	0	65.000
	Sekretar i Dyte. Zevendeskonsull.	10.050	2%	0	49.000
	Sekretar i Trete. Agjent Konsullor.	10.050	2%	0	37.450
	Atashe	10.050	2%	0	25.850